

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84-R77.1

Data: 29 gusht 2011

Origjinali: anglisht

KRYETARI I TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR

Para: Gjykatësit O-Gon Kwon, Ushtrues i Detyrës së Kryetarit
Sekretari: Z. John Hocking
Urdhër: 29 gusht 2011

PROKURORI

kundër

SHEFQET KABASHIT

PUBLIK

**URDHËR PËR ZËVENDËSIMIN E GJYKATËSVE NË NJË ÇËSHTJE PARA
DHOMËS GJYQËSORE**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Serge Brammertz

Avokatit të të Akuzuarit

Z. Michael Karnavas

Unë, O-Gon Kwon, Ushtrues i Detyrës së Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali Ndërkombëtar”);

DUKE MARRË SHËNIM se Kryetari Patrick Robinson aktualisht nuk është i pranishëm në Tribunalin Ndërkombëtar dhe se në bazë të Rregullës 21 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit Ndërkombëtar (“Rregullorja”), Zëvendëskryetari ushtron detyrën e Kryetarit në rast mungese ose paaftësisë së Kryetarit për të vepruar;

DUKE MARRË SHËNIM “Urdhër për Ricaktimin e Gjykatësve në një Dhomë”, lëshuar më 5 mars 2010;

DUKE MARRË PARASYSH Nenet 13bis (3) dhe 14(3) të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar dhe Rregullën 77 të Rregullores;

DUKE MARRË PARASYSH se paragrafi A i Rregullës 19 të Rregullores e autorizon Kryetarin që të koordinojë punën e Dhomave;

DUKE MARRË PARASYSH se në bazë të paragrafit C të Rregullës 27 të Rregullores, në çdo kohë Kryetari mund të caktojë një anëtar të një Dhome Gjyqësore, përkohësisht në një Dhomë tjetër;

DUKE MARRË PARASYSH përbërjen e Dhomave Gjyqësore të Tribunalit Ndërkombëtar siç parashtrohet në dokumentin IT/272, lëshuar më 28 shkurt 2011;

DUKE MARRË PARASYSH nevojat e administrimit të proceseve gjyqësore dhe shpërndarjes së çështjeve të Tribunalit Ndërkombëtar;

ME ANË TË KËTIJ URDHRI ÇAKTOJ vetveten, Gjykatësi O-Gon Kwon dhe Gjykatësin Howard Morrison për zëvendësimin e Gjykatësit Bakone Justice Moloto dhe Gjykatësit Guy Delvoie në Trupin Gjyqësor që shqyrton këtë çështje gjyqësore;

ME ANË TË KËTIJ URDHRI SHËNOJ se Trupi Gjyqësor në *Prokurori k. Shefqet Kabashit*, Çështja Nr. IT-04-84-R77.1, ka përbërjen e mëposhtme:

Gjykatësi Alphons Orie, Kryegjykatës

Gjykatësi O-Gon Kwon

Gjykatësi Howard Morrison

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

nënshkruar në origjinal/
Gjykatësi O-Gon-Kwon
Ushtrues i Detyrës së Kryetarit

Sot, më 29 gusht 2011

Në Hagë

Holandë

[Vula e Tribunalit]